

HETIMET E MANGËTA DHE GJYKIMET E IMËTA

(Raport i monitorimit të Departamenteve të
Përgjithshme – Divizioneve Penale gjatë vitit 2022)



Autor: Anesa Hoxha

Ekipi redaktues: Gzim Shala dhe Lavdim Makshana

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Shtator, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

PËRMBATJA

1.Përmbledhja ekzekutive	5
2.Ngarkesa e gjykatave me lëndë	6
3.Ngarkesa e prokurorive me lëndë	8
4.Politika ndëshkimore në rastet e aksidenteve fatale	9
5.Gjykimi i rasteve të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare	12
6.Tërheqjet e prokurorisë nga aktakuzat për shkak të hetimeve të mangëta	15
7.Ndjekja dhe gjykimi i krimeve të imëta	16
8.Zvarritja e rasteve në gjykata	18

LISTA E SHKURTESAVE:

DP	Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
PTh	Prokuroritë Themelore
GjTh	Gjykatat Themelore
GjTHDP	Gjykata Themelore, Departamenti i Përgjithshëm
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KRPRK	Kodi i Ri Penal i Republikës së Kosovës
PSh	Prokurori i Shtetit
ZKPSH	Policia e Kosovës
PK	Agjencia Kundër Korrupsion
AKK	Inspektorati Policor i Kosovës
IPK	Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit
RFSSL	Ministria e Punëve të Brendshme
MPB	Shërbimin Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës
SHSKUK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AAK	Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës
PSRK	Vetëvendosje
VV	

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Një nga sfidat themelore, pothuajse në të gjitha nivelet e gjyqësorit në Republikën e Kosovës, vazhdon të mbetet problematika e lëndëve të pazgjidhura. Mbase, ky është njëri ndër fenomenet që vazhdon ta mbaj gjyqësorin në qendër të vëmendjes publike. Pastaj, edhe përbrenda kësaj problematike gjyqësori i nënshtrohet edhe një kritike në përzgjedhjen e lëndëve që duhen zgjidhur, ku aludohet në atë se gjyqësori është selektiv kur kemi të bëjmë me rastet e profileve të larta publike. Kjo ngathtësi në kryerjen e punëve, gjyqësorit përveç që i ngarkohet si faturë e paaftësisë, shpërfaq edhe mungesën e përgjegjësisë profesionale dhe institucionale njëkohësisht. Kjo problematikë flet edhe për vet demokracinë në Republikën e Kosovës, kur kemi parasysh se gjyqësori është një nga shtyllat qenësore edhe të vet shtetit. Raporti në vazhdim shpalosë (mos)punën e gjyqësorit të Republikës së Kosovës në trajtimin e krimeve të përgjithshme.

Divizionet Penale të Departamenteve të Përgjithshme të Gjykatave Themelore - gjatë vitit 2022, për dallim nga viti paraprak, kanë pasur më pak lëndë në punë. Po ashtu, gjatë këtij viti, kanë zgjidhur për 13% më pak lëndë se sa në vitin paraprak. Por, në raport me numrin e lëndëve të pranuar, gjykatat kanë zgjidhur 266 lëndë më shumë. Si rrjedhojë, në fund të vitit 2021, numri i lëndëve të pazgjidhura ka rënë për 266 lëndë. Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura për gjyqtarë, IKD ka gjetur se nga 72 gjyqtarë të DP-ve, një gjyqtar brenda vitit 2022 ka arritur të zgjidh mesatarisht 228 lëndë. Gjyqtarët e GjTh në Prishtinë, në mesatare, kanë zgjidhur më së shumti lëndë (303) ndërsa më së paku ata të GjTh në Mitrovicë (150).

Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore - nuk kanë pasur progres, ku numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2022, krahasuar me vitin 2021, ka shënuar rritje për 6 mijë 196 lëndë ose 8.78%. Nga gjithsej 103 mijë e 645 lëndë penale në punë, 70 mijë e 520 lëndë apo 68.03% kanë qenë lëndë të trashëguara nga vitet paraprake. PTh kanë zgjidhur 26 mijë e 929 lëndë, ndërsa në fund të vitit 2022 kanë mbetur të pazgjidhura 76 mijë e 716 lëndë apo 74% e tyre.

IKD përmes monitorimit sistematik që i bën sistemit të drejtësisë ka monitoruar 29 seanca për 13 raste për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Duke vlerësuar se do të parandalohet tortura dhe keqtrajtimi i të pandehurve nga zyrtarët policorë, IKD vazhdon të theksoj nevojën e caktimit të mbrojtësit qysh në fazën e intervistimit në Polici, regjistrimin me audio dhe video të procesit dhe pajisjen e çdo zyrtari policor me kamera individuale në trup.

IKD në këtë raport ka gjetur se, në disa raste, për shkak të mos zhvillimit të hetimeve adekuate nga prokurorët, pas më shumë se pesë (5) viteve këta të fundit kanë hequr dorë nga ndjekja penale e të akuzuarve.

Kjo pasi veprimet kruciale hetimore nuk janë ndërmarrë në fazën e hetimeve, por vetëm në fazë të gjykimit. Sa i përket trajtimit të rasteve gjyqësore ku janë të përfshirë politikanë, IKD ka gjetur se këto raste po përcjellen me zvarritje shumë më të madhe se sa zvarritjet që hasen në rastet e tjera ku janë të përfshirë qytetarë të rëndomtë, e që disa raste për shkak të zvarritjeve kanë arritur edhe parashkrimin absolut. IKD gjatë monitorimit sistematik ka gjetur se Gjykatat janë treguar efikase në ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të imta. Në disa raste, IKD ka gjetur se në rastet e veprave penale të cilat mund të cilësoheshin si vepra penale të rëndësisë së vogël, gjykatat kanë shqiptuar dënime përafërsisht të ngjashme me dënimet e shqiptuara në rastet e korrupsionit.

2. NGARKESA E GJYKATAVE ME LËNDË

Divizionet Penale të Departamenteve të Përgjithshme - gjatë vitit 2022 e kanë përbërë rreth 15% të totalit të lëndëve që kanë qenë në punë në të gjitha Gjykatat Themelore të Kosovës, ku nga gjithsej 318 mijë e 435 lëndë, prej tyre 47 mijë 342 lëndë kanë qenë të krimeve të përgjithshme.¹



Grafiku 1: Ngarkesa dhe efikasiteti i gjykatave gjatë vitit 2022

Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2022 gjykatat kanë pasur rënie të numrit të lëndëve që DP-të kanë pranuar gjatë këtij viti (për 9%) e po ashtu edhe rënie të numrit të lëndëve në punë (për 6%). Por, nëse e krahasojmë me vitin 2021, në vitin 2022 gjykatat kanë arritur që të zgjidhin më pak lëndë se sa vitin paraqark (për 13%). Në fund të vitit 2022, nga gjithsej 47 mijë e 342 lëndë të DP-ve në punë, në gjykata kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 30 mijë e 857 lëndë.

Sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe në vitin 2022 gjykata që ka pasur më së shumti lëndë ka qenë Gjykata Themelore në Prishtinë me 18 mijë e 528 lëndë, ndërsa gjykata që ka qenë më së paku e ngarkuar është ajo e Gjakovës me 2 mijë e 376 lëndë në punë.

¹ "Raporti vjetor statistikor i Gjykatave – 2022". Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Fq.3.

Sa i përket ngarkesës me lëndë të DP-ve për një gjyqtar, Gjykata e Prishtinës po ashtu ka primatin ashtu që në vitin 2022 një gjykatës mesatarisht ka qenë i ngarkuar me 1 mijë e 238 lëndë. Ndërsa gjykatësit që në mesatare kanë qenë më së paku të ngarkuar me lëndë janë ata të Gjykatës Themelore në Mitrovicë me nga 344 lëndë të DP-ve për një gjyqtar.

Kurse sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura për gjyqtarë, nga 72 gjyqtarë të DP-ve i bie se një gjyqtar brenda vitit 2022 ka arritur të zgjidh mesatarisht 228 lëndë. Në bazë të gjykatave, i bie se gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë kanë zgjidhur më së shumti lëndë ashtu që mesatarisht një gjyqtar i kësaj gjykate ka zgjidhur 303 lëndë, kurse në anën tjetër gjyqtarët që më së paku kanë zgjidhur lëndë janë ata të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ku një gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht 150 lëndë brenda vitit 2022, apo rreth 50% më pak se sa që kanë zgjidhur gjykatësit e Prishtinës.

Në mënyrë që të peshohet drejt puna e gjyqtarëve, IKD ndër vite i kishte rekomanduar KGJK-së miratimin e Rregullores së re për Normat Orientuese për Gjyqtarë.² KGJK më 6 prill 2023 kishte miratuar këtë rregullore.³ Miratimi i kësaj rregullore paraqet një hap të rëndësishëm drejt mbajtjes së llogaridhënies të gjyqtarëve për efikasitetin e tyre, derisa implementimi në praktikë i kësaj rregullore mbetet të vlerësohet në fazat pasuese.

Ndërsa, kur jemi tek procedimi i lëndëve në shkallë të dytë, në fund të vitit 2022 është arritur që të zgjidhen 68% të lëndëve që kanë qenë në punë ashtu që nga 2 mijë e 464 lëndë në punë, janë zgjidhur 1 mijë e 684 lëndë. Krahësuar me vitin paraprak, viti 2022 ka pësuar rënie për 5% në zgjidhjen e lëndëve në shkallë të dytë, kjo pasi që në vitin 2021 nga 2 mijë e 285 lëndë në punë, ishin zgjidhur 1 mijë e 771 lëndë apo 77% të lëndëve në punë.

Me qëllim të reduktimit të lëndëve të vjetra të cilat vazhdojnë të paraqesin sfida në sistemin gjyqësor, KGJK ka miratuar kohë pas kohe plane strategjike afatgjate për përgatitje të veprimeve specifike, kështu së fundmi është miratuar Plan i Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025⁴, në kuadër të së cilës një nga obligimet që ka KGJK është shpërndarja dhe balancimi i lëndëve që janë me prioritet dhe atyre që janë më tepër se dy vite.


2 Nocaj D. "Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika". IKD. Prishtinë. Nëntor 2019. Faqe 21 (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/IKD-Drejt%C3%ABsia-Civile-Ligji-vs.-Praktika-03.11.2019-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 16 gusht 2023). Thaqi M & Nocaj D. "Drejtësia e vonuar në Kosovë" (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Drejtësia-e-vonuar-ne-Kosove-2021.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 16 gusht 2023).

3 "KGJK miraton Rregulloren për normën e punës së gjyqtarëve". Betimi për Drejtësi. 6 prill 2023 (Shih linkun: <https://betimi-perdrejtesi.com/kgjk-miraton-rregulloren-per-normen-e-punes-se-gjyqtareve/>). (Qasur për herë të fundit më 16 gusht 2023).

4 Plan i Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Fq.5.

3. NGARKESA E PROKURORIVE ME LËNDË

Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore - gjatë vitit 2022 kanë pasur në punë gjithsej 103 mijë e 645 lëndë penale. Nga të cilat 70 mijë e 520 lëndë apo 68.03% kanë qenë lëndë të trashëguara nga vitet paraprake. Sipas statistikave të raportit të Prokurorit të Shtetit gjatë vitit 2022 janë pranuar 33 mijë e 125 lëndë, ku prej tyre janë zgjidhur 26 mijë e 929 lëndë, ndërsa në fund të periudhës raportuese të vitit 2022 kanë mbetur të pazgjidhura 76 mijë e 716 lëndë apo 74% e tyre.



Grafiku 2: Ngarkesa dhe efikasiteti i prokurorive në zgjidhjen e lëndëve gjatë vitit 2022

Referuar të dhënave statistikore të PSh-së, DP-ja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë prinë sa i përket ngarkesës me numër të lëndëve me 53 mijë e 307 lëndë në punë, ndërsa më pak e ngarkuar gjatë vitit 2022 del të jetë DP-ja e Prokurorisë Themelore në Gjakovë me 4 mijë e 853 lëndë.

Po ashtu, edhe sa i përket numrit të lëndëve të pazgjidhura DP e PTh në Prishtinë prinë edhe në këtë aspekt me 45 mijë e 514 lëndë të pazgjidhura. Shprehur në përqindje i bie që 85.38% e lëndëve kanë mbetur të pazgjidhura deri në fund të vitit 2022. Kjo përqindje e lartë e lëndëve të pazgjidhura tregon për mos efikasitetin e PTh në Prishtinë në zgjidhjen e lëndëve, pasi gjatë vitit 2022 janë zgjidhur vetëm 7 mijë e 793 lëndë apo vetëm 14% e lëndëve në punë.

Edhe sipas statistikave të Raportit Vjetor të PSh-së, numri i lëndëve penale të pazgjidhura në fund të vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, ka shënuar rritje për 6,196 lëndë ose 8.78%.⁵

⁵ Raporti Vjetor i Prokurorit të Shtetit (Shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RA-PORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 16 gusht 2023).

4.POLITIKA NDËSHKIMORE NË RASTET E AKSIDENTEVE FATALE

Ngritja e sigurisë në trafikun publik mbetet një nga sfidat kryesore. Çdo vit sipas të dhënave të Policisë së Kosovës shkaktohen me mijëra aksidente. Të dhënat e Policisë së Kosovës thonë se vetëm gjatë viteve 2017-2021 janë shkaktuar mbi 80 mijë aksidente, prej të cilave afro 500 aksidente kanë përfunduar me fatalitet. Vetëm për këto vite afro 600 persona kanë humbur jetën nga aksidentet në trafikun publik.⁶



Grafiku 3: Të dhënat statistikore të PK-së për rastet e aksidenteve

Një politikë ndëshkimore adekuate konsiderohet se do të ndikonte në rritjen e sigurisë në trafikun publik. Parandalimi i personave të tjerë nga kryerja e veprës penale është njëri nga qëllimet e dënimit.⁷ Me qëllim të shqiptimit të dënimeve adekuate, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka miratuar Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore. Zbatimi i këtij udhëzuesi në 15 aktgjykimet e nxjerra gjatë vitit 2022 në rastet e aksidenteve që kanë përfunduar me fatalitet, ka qenë objekt i hulumtimit nga IKD. Gjetjet dëshmojnë për mos zbatim të plotë të këtij udhëzuesi në këto raste.

Në këto 15 aktgjykime janë të përfshirë 17 persona të dënuar ndaj të cilëve janë shqiptuar gjithsej 17 dënime. IKD nga analizimi i këtyre aktgjykimeve ka gjetur se kryesisht dënimet janë me burgim efektiv (12 dënime), derisa tri dënime janë me kusht dhe në dy raste gjykata fillimisht ka shqiptuar dënim me gjashtë muaj burgim efektiv por me



Grafiku 4: Politika ndëshkimore në rastet aksidenteve


pëlqimin e të akuzuarit ky dënim është shndërruar në gjobë. Pra, gjykatat në gjashtë raste kanë shqiptuar dënime nën kufirin minimal të përcaktuar me ligj derisa në vetëm një rast janë çekur dhe elaboruar rrethanat posaçërisht lehtësuese që kanë ndikuar në zbutjen e dënimit.⁸

6 Përgjigje nga Policia e Kosovës për IKD më 18.10.2022.

7 Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 38.; "Udhëzues për politikën ndëshkimore". Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. Fq 33. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12.01.2023).

8 P.nr.228/2014.

IKD ka gjetur se dënimi më i lartë i shqiptuar me burgim efektiv nga këto 12 dënime është me tre vite dhe atë në vetëm një rast,⁹ derisa ai më i ulëti është me tetë muaj burgim i shqiptuar në një rast,¹⁰ ndërsa me nga dy vite burgim janë katër raste¹¹ si dhe një rast është me 20 muaj burgim¹² dhe një rast tjetër me 18 muaj.¹³ Me dënim me 2 vite burgim me kusht janë dënuar dy persona¹⁴ dhe me 15 muaj burgim me kusht një person¹⁵ kurse dy raste u është zëvendësuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj në dënim me gjobë në 3000 euro¹⁶ dhe në 5000 euro¹⁷.



Grafiku 5: Rastet e aplikimit të dënimeve me burgim, gjobë dhe kusht.

9 P.nr.236/2020.

10 P.nr.82/2020.

11 P.nr.183/2022, P.nr.199/22, P.nr.236/2020, P.nr.584/2022.

12 P.nr.444/2017

13 P.nr.704/22.

14 P.nr.257/2019.

15 P.nr.1828/13.

16 P.nr.228/2014.

17 P.nr.920/21.

Gjykatat me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimeve, sipas gjetjeve të IKD-së, kanë aplikuar 96 rrethana lehtësuese derisa në anën tjetër vetëm 35 rrethana rënduese. Mirëpo problematikë tek këto rrethana vazhdon të mbetet arsyetimi i tyre, problem ky i evidentuar edhe në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.¹⁸ Në këtë drejtim, IKD ka gjetur që nga 96 rrethana lehtësuese të aplikuar nga gjykatat janë arsyetuar 43 prej tyre ndërsa 53 nuk janë arsyetuar. Tutje, IKD ka gjetur se ka një rritje pozitive sa i përket arsyetimit të rrethanave rënduese kjo pasi që nga 35 rrethana rënduese të aplikuar, 25 prej tyre janë arsyetuar ndërsa vetëm 10 nuk janë arsyetuar ashtu siç kërkohet me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore. Po ashtu, IKD ka gjetur se në asnjërin nga aktgjykimet e analizuar gjykatat nuk kanë vlerësuar dhe caktuar peshën e secilës nga rrethanat e aplikuar me rastin e shqiptimit të dënimit.¹⁹

Gjithashtu, si problematikë nga analizimi i këtyre aktgjykimeve është vërejtur edhe dyfishimi i rrethanave ashtu që nga 14 aktgjykime kur është marrë si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë nga i pandehuri, në 13 prej tyre po ashtu është marrë rrethanë lehtësuese edhe pendimi, kërkim falje, keqardhja dhe gatishmërinë e të njëjtit për t'i ofruar ndihmë viktimave dhe kompensuar përfaqësuesit e të dëmtuarve e që sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore pranimi i fajësisë mund të argumentohet përmes rrethanave të lartcekura dhe se gjykata në këto raste duhet t'i atribuoj faktet vetëm njërës rrethanë lehtësuese.²⁰

Në një rast tjetër,²¹ gjykata përveç rrethanave të tjera ka marrë si rrethanë lehtësuese për dy të pandehurit edhe kërkim faljen, mirëpo në aktgjykim tek deklaratimet e të pandehurve në seancë nuk ceket se ka pasur kërkim falje.

Sa i përket qëllimit të dënimit, gjykatat vetëm se kanë cituar cilat janë qëllimet e dënimit mirëpo në asnjërin rast nuk janë arsyetuar se si do të arrihet ai qëllim, ashtu siç kërkohet me udhëzues të politikës ndëshkimore.²² Derisa në tri raste gjykatat as nuk kanë cekur cilat janë qëllimet e dënimit të parapara me Kod por se vetëm kanë cekur se “do të arrihet qëllimi i dënimit paraparë në nenin 38”.²³

18 “Udhëzues për politikën ndëshkimore”. Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. Fq. 8. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12.01.2023).

19 Po aty. Fq. 191.

20 Po aty. Fq. 31 dhe 32.

21 P.nr.257/2019.

22 “Udhëzues për politikën ndëshkimore”. Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. Fq. 33. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12.01.2023).

23 P.nr.704/22, P.nr.82/2020, P.nr.1828/13.

5. GJYKIMI I RASTEVE TË KEQTRAJTIMIT GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS ZYRTARE

IKD në këtë raport po ashtu ka trajtuar edhe efikasitetin e institucioneve në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të përfshirjes së zyrtarëve policorë në keqtrajtimin e qytetarëve gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Shpeshherë ndodh që kredibiliteti i Policisë së Kosovës të jetë lënduar në publik pikërisht për faktin që zyrtarët policor i tejkalojnë detyrat e paracaktuara, ku gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare i keqtrajtojnë qytetarët. Përderisa, zyrtarët policorë kanë rolin mbrojtës ndaj qytetarëve, keqtrajtimi i tyre nga vet këta persona gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe udhëzimeve administrative, ndikon në humbjen e besimit në sytë e qytetarëve për rolin dhe efektin që ka Policia e Kosovës.

Gjatë vitit 2022, Inspektorati Policor i Kosovës, ka regjistruar 113 ankesa që janë bërë ndaj zyrtarëve policorë për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike. Në Departamentin e Hetimeve në IPK, me dyshimin se është kryer vepra penale e keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, janë regjistruar gjithsej 11 raste, ku si të dyshuar janë gjithsej 15 zyrtarë policorë. Prej këtyre 11 rasteve, në



Grafiku 6: Rastet e proceduara nga IPK në Prokurori

Prokuroritë kompetente janë dërguar gjithsej 10 raste, ndërsa një rast është ende në proces.²⁴ Kurse, prokuroritë nuk mbajnë të dhëna statistikore për këto raste.²⁵



Grafiku 7: Të dhënat statistikore të KGJK-së për veprën penale të keqtrajtimit

Ndërkaq, sa i përket të dhënave statistikore të KGJK-së del se për veprën penale “Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, janë akuzuar 22 persona, ku për nëntë prej tyre janë shpallur aktgjykime, nga të cilat pesë persona janë dënuar me dënime me gjobë ndërsa katër të tjerë me dënime me kusht.

²⁴ Përgjigje nga Inspektorati Policor i Kosovës e datës 09.02.2023.

²⁵ Përgjigje nga Këshilli Prokurorial i Kosovës e datës 22.02.2023.

IKD përmes monitorimin sistematik gjatë vitit 2022 ka monitoruar 29 seanca për 13 raste²⁶ ndaj zyrtarëve policorë të akuzuar për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike. IKD ka gjetur se ka raste kur një zyrtar policor për të njëjtën vepër ka të ngritura dy apo më shumë aktakuza, siç është rasti i H.K, për të cilin brenda vitit 2021 ishin ngritur dy aktakuza nga PTh në Prishtinë. Në njërin rast ai akuzohet nga Prokuroria se së bashku me policin tjetër A.H në vitin 2018 kishin keqtrajtuar të dëmtuarin i cili ishte duke u trajtuar me një rast si i dyshuar. Për këto akuza të njëjtit ishin deklaruar të pafajshëm. Kjo aktakuzë ishte konfirmuar nga Gjykata e Apelit në nëntor të vitit 2022, mirëpo deri më tani që nga konfirmimi i aktakuzës nuk është mbajtur asnjë seancë nga Themeloria edhe përkundër që kanë kaluar 10 muaj.²⁷

Në këtë rast, dy zyrtarë policor kishin xhiruar keqtrajtimin e bërë nga ana e zyrtarit policor dhe ky xhirim ishte publikuar më pas në media. Pas publikimit të këtij rasti në media, KPK kishte pezulluar nga puna prokurorin e rastit z. Eset Rama dhe IPK kishte suspenduar nga puna zyrtarët policorë. Ndaj mënyrës së trajtimit të rastit të keqtrajtimit të një të ndaluarit në stacionin policor, përmes një komunikate për media kishte reaguar edhe IKD duke vlerësuar se ka pasur një varg dështimesh të institucioneve, të cilat në fund, KPK përmes suspendimit të prokurorit të rastit, ka tentuar të mbulojë çdo dështim të zinxhirit institucional me qëllim që të “blejnë pagën” në publik pas publikimit të skandalit të torturës.²⁸ Sa i përket prokurorit të suspenduar z. Eset Rama, Gjykata Supreme vlerësoi se i njëjti nuk ishte përgjegjës për shkelje disiplinore në këtë rast.

H.K përballet edhe me një aktakuzë tjetër për keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare të cilën PTh në Prishtinë e kishte ngritur gjithashtu në vitin 2021. Ai tani akuzohet nga PTh në Prishtinë se në vitin 2020 në stacion policor kishte ushtruar dhunë ndaj një të dëmtuari. Në këtë rast, ende nuk është caktuar shqyrtimi fillestar.²⁹

Një rast tjetër i ngjashëm me rastet e lartcekura është edhe rasti i një zyrtarit policor në Mitrovicë i cili akuzohet nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë se më 6 tetor 2016, në korridorin e stacionit policor në Mitrovicë, pasi e kishin sjellë në stacion të dëmtuarin A.P e ka fyer rëndë dinjitetin e të dëmtuarit A.P,

26 Shënim: Në këto raste zyrtarët policorë përveç keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare akuzohen edhe për vepra tjera penale.

27 “Apeli konfirmon aktakuzën ndaj ish-polici Haris Kelmendi dhe policit tjetër, për keqtrajtimin e të dëmtuarit në stacion policor”. Betimi për Drejtësi. 14 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-ish-polici-haris-kelmendi-dhe-polici-tjeter-per-keqtrajtimin-e-te-demtuarit-ne-stacion-policor/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

28 IKD: Keqtrajtimi i qytetarit në stacionin policor paraqet një varg dështimesh të institucioneve. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 3 shkurt 2021. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-keqtrajtimi-i-qytetarit-ne-stacionin-policor-paraqet-nje-varg-deshtimesh-te-institucioneve/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

29“Ekskluzive: Ish-polici Haris Kelmendi edhe me një aktakuzë për keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-ish-polici-haris-kelmendi-edhe-ne-nje-aktakuze-per-keqtrajtim-gjate-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

e ka fyer rëndë dinjitetin e të dëmtuarit A.P, duke e ofenduar dhe tërhequr të njëjtin. I njëjti në shtator të vitit 2022 është dënuar me 9 muaj burgim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.³⁰

Në një rast tjetër të monitoruar nga IKD,³¹ dy zyrtarë policorë akuzoheshin nga PTh në Prishtinë se në bashkëkryerje kishin kryer veprat penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe lëndim të rëndë trupor. Sipas aktakuzës, më 21 nëntor 2012, në parkingun e një restoranti në Prishtinë, në bashkëkryerje, gjatë arrestimit të akuzuarit kanë keqtrajtuar të dëmtuarin dhe i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore. Për shkak të parashkrimit, Apeli me 30 tetor 2022 kishte ndryshuar aktgjykimin e Themelores për policët e dënuar për lëndim të rëndë trupor.³²

Përtej ndjekjes dhe gjyimit të rasteve të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, IKD rithekson se është i nevojshëm caktimi i mbrojtësit për të pandehurin qysh në fazën e intervistimit në Polici, regjistrimi me audio dhe video të proceseve të trajtimit të rasteve në stacion policor ndaj të pandehurve apo pajisja e çdo zyrtari policor me kamera individuale. Përmes këtyre masave do të parandalohet tortura dhe keqtrajtimi i zyrtarëve policorë ndaj të pandehurve.

Procesi i Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit - ka trajtuar obligimin e institucioneve shtetërore për parandalimin e torturës. Ndër të tjera, në dokumentin e RFSSL-së mbi mjetet juridike thuhet se: *“Mekanizmat e pavarur, të qasshëm dhe efektiv të ankesave dhe hetimeve duhet të jenë krijuar. Veprime të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar qasshmërinë dhe efektivitetin e mekanizmave të ankesave për personat që pretendojnë keqtrajtimin në paraburgim”*. Po ashtu, ky dokument si problematikë gjen edhe mungesën e një avokati gjatë ndalimit policor. *“Një numër i të arrestuarve pretenduan se ata nuk kishin qasje në avokatin e tyre zyrtar, pasi të ishin marrë në pyetje nga një zyrtar policie. Nga koha e arrestimit të tyre deri në fillimin zyrtar të marrjes në pyetje, ata dyshohet se ishin lënë në një harresë ligjore, e cila, në disa raste, lehtësoi kryerjen e torturave dhe keqtrajtimit nga policia”*. Po ashtu, i njëjti dokument nënvizon se *“Vizitat në terren të Mekanizmit Kombëtar Parandalues në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit zbuluan se nuk është praktikuar audio dhe video regjistrimi i intervistave gjatë intervistimit të të arrestuarve. Audio dhe video regjistrimi i intervistave policore të të arrestuarve konsiderohet si një mbrojtje e rëndësishme shtesë kundër keqtrajtimit fizik”*.

30 “Edhe në rigjykim, dënohet me 9 muaj burgim polici i akuzuar për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 9 shtator 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/edhe-ne-rigjykim-deno-het-me-9-muaj-burgim-polici-i-akuzuar-per-keqtrajtim-gjate-ushtrimit-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022.)

31 “Një vit burgim për njërin polic të akuzuar për lëndim të rëndë trupor, tjetrit i refuzohen akuzat”. Betimi për Drejtësi. 12 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/edhe-ne-rigjykim-deno-het-me-9-muaj-burgim-polici-i-akuzuar-per-keqtrajtim-gjate-ushtrimit-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022.)

32 “Për shkak të parashkrimit, Apeli ndryshon aktgjykimin e Themelores për policët e dënuar për lëndim të rëndë trupor”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-parashkrimit-ape-li-ndryshon-aktgjykimin-e-themelores-per-policet-e-denuar-per-lendim-te-rende-trupor/>). (Qasur për herë të fundit më 18 gusht 2023).

Funksionalizimi i kamerave në të gjitha vendet e ndalimit në menaxhim të Policisë së Kosovës është njëra ndër aktivitetet e parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Sundim të Ligjit.³³ Raporti mbi zbatimin e këtij plani e ka evidentuar këtë aktivitet si të përmbushur, përkundër faktit se vet raporti jep sqarime se ende nuk janë funksionalizuar kamerat në të gjitha vendet e ndalimit.³⁴ Për këtë arsye, në linjë me këtë aktivitet dhe për shkak të rëndësisë që ka, Policia e Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera kompetente duhet të angazhohen seriozisht për funksionalizimin e kamerave në të gjitha vendet e ndalimit.

Pra, siç vërehet nga kjo që u tha më lartë, këto sjellje të papërgjegjshme dhe joprofesionale nga ana e zyrtarëve policor, janë edhe një tregues shtesë për Policinë e Kosovës, për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe për të gjitha organet tjera mbikëqyrëse, që t'i trajtojnë me seriozitet të lartë këto sjellje. Zyrtari policor, është shëmbëlltyra e një shteti. Sjelljet dhe veprimet e tij, përveç që janë treguesit e parë se si perceptohet një vend, gjithashtu, janë edhe pasqyrë për funksionimin e demokracisë ose jo të atij vendi.

6.TËRHEQJET E PROKURORISË NGA AKTAKUZAT PËR SHKAK TË HETIMEVE TË MANGËTA

IKD nga rastet e monitoruara gjatë vitit 2022 ka gjetur disa raste kur Prokuroria pas më shumë se pesë (5) vite nga ngritja e aktakuzës është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve. Kjo ka ardhur si rezultat i mos ndërmarrjes së veprimeve hetimore adekuate nga Prokuroria në fazën hetimore.

I këtillë është rasti ndaj Z.B ndaj të cilit PTh në Gjilan kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë, ku e ngarkonte për uzurpim të kundërligjshëm.³⁵ Për këtë rast, ishin caktuar 10 seanca gjyqësore.³⁶ Gjatë gjykimit, gjykata urdhëroi kryerjen e ekspertizës gjeodezike, e cila nuk ishte kryer në fazën e hetimeve. Pas kryerjes së ekspertizës, afro shtatë vite pas ngritjes së aktakuzës, Prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale me arsyetimin se pas ekspertizës së matjeve gjeodezike që kishte urdhëruar gjykata të bëheshin, nuk qëndronin pretendimet e të dëmtuarës për uzurpim të pronës, por se vet ajo kishte uzurpuar një pjesë të pronës publike.³⁷

Gjithashtu në një rast tjetër³⁸ Prokuroria qysh në seancën e shqyrtimit fillestar është tërhequr nga akuza për njërin të akuzuar. Aktakuza e drejtpërdrejtë i ngarkonte dy (2) të pandehur për kryerje të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje. Tërheqja e Prokurorit të Shtetit nga aktakuza ndaj S.M u bë me

33 "Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026". (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

34 Raporti Vjetor për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit". Mars 2023, Fq.79. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Raporti-1-vjecar-FINAL.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

35 Aktakuza PP.II.nr.1130/2015.

36 Përgjigje për IKD nga Gjykata Themelore në Gjilan e datës 23.12.2022.

37 "Prokuroria tërhiqet nga ndjekja për uzurpim të pronës në Kllokot, shpallet aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit". Betimi për Drejtësi. 12 janar 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-terhiqet-nga-ndjekja-per-uzurpim-te-prones-ne-kllokot-shpallet-aktgjykim-refuzues-ndaj-te-akuzuarit/>). (Qasur për herë të fundit më 14.12.2022).

38 Aktakuza PP.II.nr.1807/21.

arsyetimin se aktakuza është bazuar kryesisht në deklaratën e të akuzuarit tjetër, A.Gj, i cili në shqyrtim fillestar ndryshoi deklaratën e tij.³⁹

Derisa në një rast tjetër, Prokuroria më 14 maj 2018 kishte ngritur aktakuzë për rrezikim të trafikut publik ndaj M.S, për çka ky i fundit akuzohej se duke shkelur rregullat e trafikut publik, ka shkaktuar aksident, me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore ngasëses së biçikletës. Para ngritjes së aktakuzës, Prokuroria nuk kishte kryer fare ekspertizë të komunikacionit. Kjo ekspertizë u urdhërua në Gjykatë. Ekspertiza konstatonte se shkaktar i aksidentit nuk kishte qenë i pandehuri, por ngasësja e biçikletës, përkatësisht e dëmtuara. Pas këtyre konstatimeve, mbi katër vite pas ngritjes së aktakuzës, Prokuroria u tërhoq nga aktakuza.⁴⁰

Mos zhvillimi i hetimeve adekuate në këto raste, sjell deri tek situatat e përshkruara si më lartë. Kjo mënyrë e veprimit ngarkon punën e sistemit të drejtësisë dhe mbi të gjitha, cenon të drejtat e palëve në procedurë. Zhvillimi i hetimeve, ligjërish dhe konceptualisht, është faza kur Prokurori i Shtetit kryen të gjitha hetimet derisa ballafaqimi i fakteve dhe provave bëhet në gjykatë. Hetimet e cunguara në Prokurori, humbin efektivitetin edhe të vet gjykimit. Për më tepër, kjo qasje paraqet edhe administrim jo adekuat të drejtësisë.

7.NDJEKJA DHE GJYKIMI I KRIMEVE TË IMËTA

Gjatë monitorimit, IKD ka gjetur raste kur sistemi i drejtësisë ka ndjekur dhe gjykuar raste të veprave penale të rëndësisë së vogël, të cilat sipas Kodit NR. 06/L-074 Penal [neni 11] nuk paraqesin vepër penale.⁴¹ Sipas komentarit të Kodit Penal, *“duke përjashtuar veprat e këtilla nga katalogu i veprave penale, gjykatave u bëhet e mundshme që të mos ngarkohen me cikërrime dhe qytetarët të mos trajtohen si delikuent për vepra të këtilla”*.⁴² Përkundër se sistemi i drejtësisë ka ndjekur dhe gjykuar raste të kësaj natyre, IKD ka evidentuar raste kur dënimet e shqiptuara në këto raste kanë qenë pothuajse të ngjashme me rastet e veprave penale të korrupsionit.

39; “Njëri i akuzuar e pranon fajësinë se vodhi mjete të punës, për tjetrin prokurori tërhiqet nga aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 4 korrik 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/njeri-i-akuzuar-e-pranon-fajesine-se-vodhi-mjete-te-punes-per-tjetrin-prokurori-terhiqet-nga-aktakuza/>). (Qasur për herë të fundit më 14.12.2022).

40 “Me propozimin e prokurores për ndryshim të akuzës, shtyhet gjykimi ndaj të akuzuarit për shkaktim të aksidentit”. Betimi për Drejtësi. 20 shtator 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/me-propozimin-e-prokurores-per-ndryshim-te-akuzes-shtyhet-gjykimi-ndaj-te-akuzuarit-per-shkaktim-te-aksidentit/?fbclid=IwAR1J2nVqlfUYjFNL6gfdë9C1Mo3RDQS4ëJVudbr58bl3ISK8QcRH-BHzs>). (Qasur për herë të fundit më 14.12.2022); Përgjigje për IKD nga Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Viti e datës 16.12.2022.

41 Hashani G. dhe Thaqi M. “Krimet e Përgjithshme në Kosovë, Ligji vs Praktika”. Nëntor 2019. Fq 36. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Krimet-e-P%C3%ABrgjithshme-ne-Kosove-ligji-vs-praktika-10.11.2019-ME-BALLINE-1.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023); “10 dënimet “spektakolare” të shpallura nga gjykatat e vendit për “hajnat” e vegjël”. Betimi për Drejtësi. 10 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/10-denimet-spektakolare-te-shpallura-nga-gjykatat-e-vendit-per-hajnat-e-vegjel/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022).

42 Prof. Dr. Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Dr.Sc. Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, 2014, Fq.42.

Si rast i tillë është rasti ku Gjykata Themelore në Gjilan e ka dënuar me tre muaj burgim me kusht të akuzuarin i cili në shkurt të vitit 2021 në një market kishte vjedhur një shishe me alkool në vlerë rreth 12 euro, rrjedhimisht i njëjti kishte dal pa e bërë pagesën.⁴³

Veprime të ngjashme kishte bërë edhe një i akuzuar tjetër, i cili nga Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Viti ishte dënuar me 400 euro.⁴⁴ Ai akuzohej nga Prokuroria se në shkurt të vitit 2021 kishte hyrë në një market dhe kishte marrë një shishe raki duke e fshehur atë nën xhaketen që e kishte të veshur ndërsa pagesën e kishte bërë vetëm për një pije tjetër të thjeshtë. Me këto veprime, i akuzuari të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 21 euro.

Se kishte marrë një sasi të mishit të terur në vlerë 70 euro nga një market dhe e kishte fshehur nën xhakete duke tentuar të dalë nga marketi pa paguar ishte ngarkuar me aktakuzë edhe një i akuzuar tjetër të cilin Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me 6 muaj burgim me kusht dhe 150 euro gjobë me kusht.⁴⁵ Ky dënim i shqiptuar për këtë rast, është pothuajse ekuivalent me disa nga dënimet për rastet e korrupsionit.⁴⁶ Ish-drejtorit i Emergjencës në Shërbimin Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës, Basri Lenjani, ishte dënua nga GjTh në Prishtinë me 6 muaj burgim me kusht dhe 500 euro gjobë për mos raportim të pasurisë, vepër penale kjo e cila bën pjesë në kapitullin e veprave penale të korrupsionit. Rast i ngjashëm është edhe rasti i zëvendësministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi e cila nga GjTh në Prishtinë është dënua me 500 euro gjobë, pasi e njëjta është shpallur fajtores se ka deklaruar me vonesë pasurinë.⁴⁷ Pra, në këto raste, dënimi i shqiptuar ka qenë pothuajse ekuivalent me rastin e një personi që kishte tentuar të dalë pa e paguar mishin e terur në vlerë prej 70 eurove.

Gjykata Themelore	Vepra Penale	Veprimi Kriminal	Dëmi	Dënimi
Gjilan	Vjedhja	Vjedhja e një shishe alkooli	21euro	Tre (3) muaj burgim me kusht
Gjilan-Dega në Viti	Vjedhja	Vjedhja e një shishe raki	21euro	400 euro gjobë
Prishtinë	Vjedhja	Mish i terur	70 euro	6 muaj burgim me kusht dhe 150 euro gjobë me kusht

Grafiku 8: Dënimet e shqiptuara në rastet e krimeve të imëta

43 “Pranoi se vodhi një “Smirnoff Vodka” në vlerë mbi 10 euro, dënohet me tre muaj burgim me kusht”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pranoi-se-vodhi-nje-smirnoff-vodka-ne-vlere-mbi-10-euro-denohet-me-tre-muaj-burgim-me-kusht/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022).

44 “400 euro gjobë të akuzuarit se vodhi një shishe raki në vlerë 21 euro”. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-400-euro-gjobe-i-akuzuari-se-vodhi-nje-shishe-raki-ne-etc/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022).

45 “6 muaj burgim me kusht dhe gjobë ndaj të akuzuarit se vodhi mish të terur në një market në Fushë Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 13 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/6-muaj-burgim-me-kusht-dhe-gjobe-ndaj-te-akuzuarit-se-vodhi-mish-te-terur-ne-nje-market-ne-fushe-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 18 gusht 2023).

46 “Basri Lenjani dënohet me 6 muaj burgim me kusht dhe 500 euro gjobë për mosraportim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 6 qershor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/basri-lenjani-denohet-me-6-muaj-burgim-me-kusht-dhe-500-euro-gjobe-per-mosraportim-te-pasurise/?fbclid=IwAR1QCW-PNfkm96SB0Q1JkAAWfkPkjMXiJ9Au93RsFAIneQy9mfthSb9tA6c>). (Qasur për herë të fundit më 18 gusht 2023).

47 “Ekskluzive: Zëvendësministria Liza Gashi dënohet me 500 euro gjobë për deklarim të pasurisë me vonesë”. Betimi për Drejtësi. 17 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-zevendesministria-liza-gashi-denohet-me-500-euro-gjobe-per-deklarim-te-pasurise-me-vonese/>). (Qasur për here të fundit 18 gusht 2023).

8.ZVARRITJA E RASTEVE NË GJYKATA

Derisa nga IKD është analizuar se si veprat penale të rëndësisë së vogël janë duke e ngarkuar gjyqësorin dhe prokurorinë, e njëjta ka evidentuar edhe disa raste të monitoruara gjatë vitit 2022 e të cilat ka më shumë se një dekadë që janë në procese gjyqësore dhe për të njëjtat ende nuk është nxjerrë vendim meritör. IKD përmes raporteve dhe reagimeve gjithnjë ka rekomanduar dhe kërkuar nga institucionet e sistemit të drejtësisë që të merren masat adekuate që rastet të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm kohor, derisa tani në gjykatat tona ka raste që janë ngritur nga ish Prokuroritë Publike të Qarkut dhe nuk kanë marr ende epilog nga gjykatat tona për arsye të ndryshme.

Në vitin 2007, ish-Prokuroria Publike e Qarkut kishte ngritur aktakuzë ndaj Rr.H për grabitjen e një çante në shtëpinë e të dëmtuarës në Fushë Kosovë. Mirëpo edhe pas 15 vitesh nga ngritja e aktakuzës ende nuk është mbajtur seanca fillestare në këtë rast. Gjykata kishte caktuar seancën e 23 marsit 2022 për këtë rast, por se në mungesë të akuzuarit e njëjta përsëri kishte dështuar të mbahej, pasi që sipas mbrojtësit të akuzuarit, ky i fundit nuk jetonte në Kosovë.⁴⁸

Në vitin 2008 ish-Prokuroria Publike e Qarkut kishte ngritur aktakuzë ndaj Z.I për punime ndërtimore të kundërligjshme në vitin 2006. Shqyrtimi kryesor në këtë rast kishte nisur në nëntor të vitit 2021.⁴⁹ Ndërsa në seancën e fundit që është mbajtur për këtë rast ku kishte qenë i ftuar si dëshmitar inspektori i punës që kishte përpiluar procesverbalin e rastit, pothuajse në të gjitha pyetjet ishte përgjigjur se nuk i kujtoheshin detajet nga rasti kritik.⁵⁰ Pas 17 viteve nga ngritja e aktakuzës, në shkurt të vitit 2023 i akuzuari është shpallur fajtor në këtë rast.⁵¹

Edhe Kreu i Federatës së Futbollit të Kosovës-së, A.A, tash e më shumë se tetë vite është duke u përballur me akuza për një rast që dyshohet se ka ndodhur në vitin 2012. Epilogun në shkallë të parë ky rast e mori më 5 korrik 2019. Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, mirëpo pas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga mbrojtësit e dy të akuzuarve, Gjykata Supreme në korrik të vitit 2020 e ka kthyer rastin në rigjykim. Pas kthimit të rastit në rigjykim, kjo lëndë fillimisht i ishte ndarë në punë gjykatësit Kujtim Krasniqi e më pas kjo lëndë është transferuar tek gjykatësja Medie Bytyqi.

48 "Pothuajse 15 vjet pas ngritjes së aktakuzës, dështon të nis gjykimi për grabitjen e çantës në shtëpinë e të dëmtuarës në Fushë Kosovë". Betimi për Drejtësi. 23 mars 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pothuajse-15-vjet-pas-ngritjes-se-aktakuzes-deshton-te-nis-gjykimi-per-grabitjen-e-cantes-ne-shtepine-e-te-demtuaries-ne-fushe-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

49 "Deklarohet i pafajshëm i akuzuari se nuk siguroi vendin e punës ku u rrëzua punëtori dhe humbi jetën". Betimi për Drejtësi. 3 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-se-nuk-siguroi-vendin-e-punes-ku-u-rrezua-punetori-dhe-humbi-jeten/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

50 "Inspektori i punës thotë se nuk i kujtohet thuajse asgjë lidhur me rastin e vdekjes së punëtorit në vendpunishte". Betimi për Drejtësi. 28 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/inspektori-i-punes-thote-se-nuk-i-kujtohet-thuajse-asgje-lidhur-me-rastin-e-vdekjes-se-punetorit-ne-vendpunishte/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

51 "2 vite burgim ndaj të akuzuarit se nuk siguroi vendin e punës, ku u rrëzua punëtori në vendpunishte dhe vdiq nga lëndimet". Betimi për Drejtësi. 14 shkurt 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/2-vite-burgim-ndaj-te-akuzuarit-se-nuk-siguroi-vendin-e-punes-ku-u-rrezua-punetori-ne-vendpunishte-dhe-vdiq-nga-lendimet/>). (Qasur për herë të fundit më 01.03.2023).

Kjo gjykatëse tentativën e parë për fillimin e rigjykimit ndaj A.A dhe M.R e kishte bërë më 24 mars 2021, kur kishin kaluar më shumë se tetë muaj pas kthimit të rastit në rigjykim. Megjithatë, kjo seancë kishte dështuar të mbahej për shkak të mungesës së të dy akuzuarve. Më pas, gjykatësja Bytyqi, me akt përcjellës më 28 qershor 2021, apo mbi tre muaj pas seancës së fundit, e cila kishte dështuar të mbahej, këtë lëndë e kishte deleguar për procedim të mëtutjeshëm në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Penal, me arsyetimin se për veprën penale “*detyrimi në tentativë*”, ligji parasheh dënimin prej një deri në dhjetë vjet burgim efektiv.⁵²

Gjithashtu në një rast tjetër ku vepra penale ishte kryer në nëntor të vitit 2012, për shkak të zvarritjeve procedurale, tanimë ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale. Dy zyrtarë policorë me aktakuzën e ngritur në vitin 2015 nga PTh në Prishtinë akuzoheshin se në bashkëkryerje kishin kryer veprat penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe lëndim të rëndë trupor. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte mbajtur më 15 shkurt 2017. Për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare kishte arritur parashkrimi më 21 nëntor 2018. Derisa gjykimi për veprën tjetër penale ka filluar rishtazi në shtator të vitit 2022, pasi që gjykatësja e rastit e kishte pranuar lëndën më 15 maj 2022. Për njërin të akuzuar, gjykata kishte marrë aktgjykim refuzues ndërsa për tjetrin aktgjykim dënues.⁵³ Mirëpo me rastin e ankesës, Gjykata e Apelit konstatoi parashkrimin absolut edhe për të pandehurin e tjetër.⁵⁴

Gjatë monitorimit IKD ka gjetur zvarritje të theksuar edhe tek rastet e politikanëve të akuzuar për vepra të ndryshme penale. I tillë është rasti i deputetit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj. PTh në Prishtinë më 6 janar të vitit 2017 kishte ngritur aktakuzë për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm ndaj Lekajt, se në nëntor të vitit 2015 kishte hedhur gaz lotsjellës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mirëpo për këtë rast, nga viti 2017 ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar. Më 7 prill 2022 ishte paraparë të mbahej kjo seancë mirëpo se i njëjti nuk ishte paraqitur në seancë dhe gjykata nuk ka pasur flete kthesë nëse Lekaj ishte ftuar me ftesë të rregullt apo jo,⁵⁵ derisa seanca e radhës është caktuar në fund të marsit 2023, e cila për shkak të mungesës së të akuzuarit Lekaj nuk u mbajt.⁵⁶

52 “Mbrotën në heshtje kreu i FFK-së, Agim Ademi dhe Muharrem Rama, të akuzuar për detyrim”. Betimi për Drejtësi. 7 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbrohen-ne-heshtje-kreu-i-ffk-se-agim-ademi-dhe-muharrem-rama-te-akuzuar-per-detyrim/>). (Qasur për herë të fundit më 10.03.2023).

53 “Një vit burgim për njërin polic të akuzuar për lëndim të rëndë trupor, tjetrit i refuzohen akuzat”. Betimi për Drejtësi. 12 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nje-vit-burgim-per-njerin-polic-te-akuzuar-per-lendim-te-rende-trupor-tjetrit-i-refuzohen-akuzat/>). (Qasur për herë të fundit më 21.12.2022).

54 Aktgjyrimi i Gjykatës së Apelit. PA1.nr.1684/2022.

55 “Ekskluzive: Pal Lekaj do të përballet me aktakuzën e ngritur më 2017 për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 7 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-pal-lekaj-do-te-perballet-me-aktakuzen-e-ngritur-me-2016-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022);

56 Përgjigje për IKD nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 27.02.2023.; “Do të urdhërohet verifikim adrese ndaj Pal Lekajt, shtyhet gjykimi për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 29 mars 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/do-te-urdherohet-verifikim-adrese-ndaj-pal-lekajt-shtyhet-gjykimi-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

Për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend dhe pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare në mars të vitit 2018, po akuzohet edhe deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Valon Ramadani. Ndaj këtij të fundit ishte ngritur aktakuza nga Prokuroria Themelore në Prishtinë më 30 korrik 2019, ndërsa shqyrtimi fillestar ishte mbajtur në korrik të vitit 2021 ku ai ishte deklaruar i pafajshëm.⁵⁷ Pas konfirmimit të akuzës nga Gjykata e Apelit, më shumë se një vit për këtë rast nuk është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor. GjTh në Prishtinë e arsyeton këtë me numrin e madh të lëndëve në punë.⁵⁸ Po ashtu, situatë e njëjtë paraqitet edhe me rastin e deputetes nga radhët e AAK-së Time Kadrijaj, e cila akuzohet për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”. Pothuajse shtatë vite nga ngritja e aktakuzës, nuk është mbajtur asnjë seancë. Dy seanca ishin planifikuar të mbaheshin, njëra në dhjetor të 2016-ës e tjetra në shkurt të 2017-tës por që të dyja kishin dështuar të mbaheshin.⁵⁹

Rast ilustrativ i dështimit të gjykatës në rastet ndaj politikanëve është edhe rasti ndaj ministrit të Punëve të Brendshme Xhelal Sveçla dhe të tjerëve, të cilëve më 27 qershor të vitit 2023 iu është parashkruar aktakuza për huliganizëm gjatë protestës së VV-së në vitin 2013. Lidhur me zvarritjet dhe parashkrimin e këtij rasti, një ndër arsyetimet e gjykatës kishte qenë mungesa e të pandehurve në seancë.⁶⁰ Ndryshe, “Betimi për Drejtësi”, kishte njoftuar paraprakisht se ky rast do të arrinte parashkrimin.⁶¹ Ky rast ishte gjykuar nga gjykatësi i Departamentit të Përgjithshëm, Eroll Gashi.⁶²

E për trajtimin jo efikas ta rasteve të politikanëve nga gjyqësori dhe mos respektimin e afateve ligjore IKD nga monitorimi sistematik që i bën sistemit të drejtësisë ka evidentuar raste të tilla edhe vitet e mëhershme me çka ka konsideruar se kjo qasje e gjyqësorit krijon një percepticion negativ tek publiku për mungesë të guximit të trajtimit të rasteve të politikanëve nga ana e gjykatave, veçanërisht, nëse rastet e të njëjtëve parashkruhen.⁶³

Mbase, edhe ky raport, ngjashëm sikurse raportet e mëparshme të IKD-së, vë në spikamë, nëpërmes fakteve, problemet serioze të gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

57 “Deputeti Valon Ramadani deklarohet i pafajshëm për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend dhe pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-valon-ramadani-deklarohet-i-pafajshem-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend-dhe-pengimin-e-personave-zyrtare-ne-kryerjen-e-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022).

58 “Pothuajse 1 vit asnjë seancë ndaj deputetit Valon Ramadani, gjykata arsyetohet me numrin e madh të lëndëve”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pothuajse-1-vit-asnje-seance-ndaj-deputetit-valon-ramadani-gjykata-arsyetohet-me-numrin-e-madh-te-lendeve/>). (Qasur për herë të fundit më 22.12.2022).

59 Përgjigje nga Gjykata Themelore në Prishtinë për IKD. 14 gusht 2023.

60 “Parashkrimi i veprave penale ndaj ministrit Sveçla dhe të tjerëve, Gjykata arsyetohet me mungesën e të pandehurve në seanca”. Betimi për Drejtësi. 13 korrik 2023 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/parashkrimi-i-veprave-penale-ndaj-ministrit-svecla-dhe-te-tjereve-gjykata-arsyetohet-me-mungesen-e-te-pandehurve-ne-seanca/>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

61 “Kur gjykata dhe gjyqtari dështojnë, Ministrit Sveçla dhe të tjerëve iu parashkruhen veprat penale”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kur-gjykata-dhe-gjyqtari-deshtojne-ministrit-svecla-dhe-te-tjereve-iu-parashkruhen-veprat-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 17 gusht 2023).

62 Thaqi M.: “Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme”. Prishtinë. Korrik 2022. Fq.15,16,17.

63 Thaqi M.: “Sfidat në trajtimin e krimeve të përgjithshme”. Prishtinë. Korrik 2022. Fq. 6-9.

